

KONTRATE DHURIMI
KUOTASH

Ne Tirane, sot ne daten 28/12/2023 (dymije e njezete e tre), nenshkruhet kjo Kontrate Dhurimi Kuotash, me kushtet si me poshte:

Z. Dritan Bedo, i biri i Ramadan, i datelindjes 04.03.1982, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Pasaportes me numer personal I20304084M, **me poshte e quajtur "DHURUESI"**

Dhe

Z. Dardi Çinari, i biri i Ali, i datelindjes 23.01.1979, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit me numer personal H90123061A, **me poshte i quajtur "PRANUESI I DHURIMIT"**

Dhe

Dhenese e Pelqimit: Znj. Fevriola Bedo, e datelindjes 27/02/1984, lindur ne Korçe dhe banuese ne Tirane, gjendja civile "e martuar", identifikuar me leternjoftimin me nr. personal I45227075I, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, bashkeshorte e Z.Dritan Bedo.

MEQENESE EKZISTOJNE KUSHTET

HYRJE

Duke konsideruar faktin se Z. Dritan Bedo eshte ortak i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "GLOBE SHOPS" SHPK, regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 15/05/2015, me NIPT L51715010G dhe zoteron 100% te kapitalit te shoqerise.

Duke konsideruar faktin se Dhuruesi Z. Dritan Bedo deshiron t'ja dhuroje kuoten qe ai zoteron ne shoqeri Z. Dardi Çinari, dmth 1 kuote, qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise.

Duke konsideruar faktin se Z. Dardi Çinari deklaroi se deshiron te pranoje dhurimin nga Z.Dritan Bedo, dmth 1 kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve te shoqerise "GLOBE SHOPS" SHPK nepermjet Vendimit Nr.203, dt.28.12.2023 ka vendosur qe kuoten qe Z. Dritan Bedo zoteron, t'ja dhuroje Z. Dardi Çinari.

Neni 1

Qellimi i kontrates

1.Kjo kontrate sherben per percaktimin e kriterëve, procedurave dhe menyres se tranferimit te pronesisë nga Dhuruesit, tek Pranuesi i dhurimit.

2.Ne percaktim te kushteve, palet konsiderojne te ligjshme permbajtjen e saj dhe marrin persiper te ekzekutojne veprimet e tyre brenda kushteve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 2
Objekti i kontrates

1. Objekti i kesaj kontrate eshte transferimi i pronesise me ane te dhurimit te kontributeve te kapitalit nga ortakut ekzistues tek ortakut e ri, si me poshte vijon:

- *Z. Dritan Bedo i transferon nepermjet dhurimit 1 kuote, qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise, Z. Dardi Çinari.*

2. Dhurimi i kuotes se mesiperme nga ortakut ekzistues ne favor te ortakut te ri do te behet pa kundershperblim, apo detyrim tjeter ligjor.

Neni 3
Pergjegjesite dhe garanci te paleve

1. Dhuruesi, nepermjet kesaj kontrate, garanton Pranuesin e Dhurimit si me poshte:

- a) ka barre hipotekore mbi kuotat e shoqerise "Globe Shops" SHPK si garanci per linjen e kredive te akorduara nga "Banka Credins" sh.a;
- b) "Banka Credins" sh.a, do te jape pelqimin e saj per dhurimin e kuotave.
- c) se miratimi per transferimin e kuotes ne drejtim te Pranuesit te Dhurimit eshte marre ne pajtim te plote me ligjin tregtar ne fuqi dhe dispozitat statutore nga organet vendimarrrese te shoqerise;
- d) i ka dhene Pranuesit te Dhurimit çdo informacion te nevojshem ne lidhje me detyrimet e shoqerise apo pretendime financiare te paleve te treta ndaj shoqerise;
- e) dhuruesi deklaron nen pergjegjesine e tij personale se me nenshkrimin e kesaj kontrate, ai heq dore nga te gjitha te drejtat qe i kane takuar ne cilesine e ortakut ne shoqeri, apo çdo te drejte tjeter pa kufizim ku perfshihen te drejta pune, dividenti etj.

2. Pranuesi i Dhurimit, nepermjet kesaj kontrate":

- a) pranon dhurimin e kuotave te shoqerise "Globe Shops" SHPK, me çdo te drejte dhe detyrim qe ajo ka.
- b) pranon barren hipotekore mbi kuotat e Shoqerise "Globe Shops" SHPK, ne favor te "Credins Bank" Sh.a.

Neni 4
Efektet e kontrates

1. Kjo kontrate ka fuqine e ligjit per palet nga momenti i nenshkrimit te saj.

2. Kontrata ka efekt per palet e treta ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 5
Informacioni konfidencial

Palet detyrohen te mbajne te fshehte te gjitha dokumentacionin, te dhenat dhe çdo informacion tjeter te perfituar gjate marredhenies se tyre ne perputhje me kete kontrate.

Neni 6
Transferimi i te drejtave

1. Menjehere mbas nenshkrimit te paleve, kontrata do te regjistrohet ne regjistrin tregtar per te bere te mundur transferimin e kuotes ne emer te ortakut te ri Z. Dardi Çinari.

2. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, dhuruesi zhvishet teresisht nga kuota e dhuruar sipas kesaj kontrate si dhe nga çdo e drejte tjeter mbi te, dhe zoteruesi i saj behet Pranuesi i Dhurimit, Z. Dardi Çinari.

Neni 7

Interpretimi i kontrates

1. Nese do te jete e nevojshme te behet interpretimi i kesaj kontrate, do te synohet te percaktohet se kush ka qene qellimi real dhe i perbashket i te dyja paleve, pa u mbeshtetur ne kuptimin literal te fjaleve, dhe gjithashtu duke vleresuar sjelljen e tyre ne teresi, perpara dhe pas perfundimit te kesaj kontrate.
2. Kushtet e kesaj kontrate do te interpretohen njera pas tjetres, duke dhene secila kuptimin qe rrjedh nga teresia e kontrates ne fjale. Kontrata do te interpretohet ne konfidence nga palet.

Neni 8

Ligji i aplikueshem dhe Gjykata kompetente

- 1 Kontrata eshte hartuar dhe interpretuar ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe ligjet tregtare ne fuqi.
- 2 Dhuruesit dhe Pranuesi i dhurimit angazhohen te bejne cdo perpjekje te zgjidhin mosmarreveshjet apo konfliktet e krijuara midis tyre, lidhur me kete kontrate nepermjet negociemeve te drejteperdrejta.
- 3 Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve apo konflikteve midis tyre, ato do ti drejtohen juridiksionit gjyqesor per zgjidhjen e tyre.

Neni 9

Dispozita perfundimtare

Kjo Kontrate Dhurimi Kuotash perben vullnetin e plote te paleve dhe hartohet ne 6 (gjashte) kopje me te njejten vlere ligjore

PALET KONTRAKTORE


DHURUESI


Z. Dritan Bedo



PRANUESI I DHURIMIT

Z. Dardi Çinari





DHENESE E PELQIMIT

Znj.Fevriola Bedo



VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKUT TE VETEM

TE SHOQERISE "GLOBE SHOPS" SHPK

NR. VENDIMI 203 DATE 28/12/2023

Ne Tirane, sot me date 28/12/2023 (dy mije e njetete e tre) u thirr dhe u mbajt mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem te shoqerise "Globe Shops" SHPK, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit, me date 15/05/2015, pajisur me L51715010G, te perbere nga:

- Z. Dritan Bedo - Ortak me 100 % te kuotave

Mbledhja e Asamblese se Ortakut te Vetem te Shoqerise "Globe Shops" SHPK u zhvillua ne seline e shoqerise e cila ndodhet ne Tirane , Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajes, Pallati Globe, Ndertesa 124, Hyrja 10, Kati 2-te, kodi postar 1023.

Te pranishem ne Mbledhje jane:

- Z. Dritan Bedo ne cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise "Globe Shops" SHPK, i cili zoteron 100 % te kuotave te shoqerise.

Pjesmarrja lejon vendimarrjen ne perputhje me Statusin e Shoqerise dhe Ligjin Nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Asambleja ra dakord dhe Vendosi:

- Miratimin per dhurimin nga Z. Dritan Bedo, i datelindjes 04.03.1982, identifikuar me Letemjoftimin me Nr. Personal I20304084M ne favor te Z. Dardi Çinari, i datelindjes 23.01.1979, identifikuar nga Pasaporta me Nr. Personal H90123061A, 100% te kontributeve qe Z. Dritan Bedo zoteron ne shoqerine "Globe Shops" SHPK. Pra, Z. Dritan Bedo do t'i dhuroje Z. Dardi Çinari kuoten e tij qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ASAMBLEJA E ORTAKUT TE VETEM

ORTAKU I VETEM

Z. Dritan Bedo






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L51715010G
2. Data e Regjistrimit	15/05/2015
3. Emri i Subjektit	GLOBE SHOPS
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	14/05/2015
6. Kohëzgjatja	Nga: 14/05/2015
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajes, Pallati Globe, Ndertesa 124, Hyrja 10, Kati 2-te, kodi postar 123
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Tregti, Import - eksport , me shumice e pakice te pajisjeve elektronike, elektro-shtepiake, si dhe servisin e tyre, servis kompjuteresh dhe pajisje telekomi, pajisje hidrosanitare, lojera -fati, bar - bufe-restaurant - hotele, mallra ushqimore, industriale, konfeksione, materiale ndertimi, fruta -perime. Tregti me shumice dhe pakice i pajisjeve dhe sistemeve per mbrojtjen nga zjarri dhe sistemeve te tjera sigurimi dhe detektimi.Germime dheu, murature e beton arme, prishje dhe punime toke te germuar. Prodhime elemente inerte-gure, betoni e beton arme te zakonshme e pararendur, gure dekorative Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore deri ne 5 kate dhe mbi 5 kate. Rikonstruksione, ndertime banesa me skelet mbi 8 kate. Ndertim rrugesht te te gjitha kategorive, punime mirembajtjeje dhe sinjalizimi ne rruge, ndertim mbishtresa rrugore.Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10 m dhe mbi 10 metra , eskada, ura metalike, te varura,ndertim tunele rrugore, punime karpentieri druri. Ndertim ujesjellesi - kanalizime - kanale e impiante



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

vaditjeje, Sillosa kulla, kulla uji etj prej beton arme-metalike.Perforcim themeli e punime nentokesore, izolime mbi dhe nen tokesore nga ujerat, themele te veçanta. Instalimi i impianteve higjienike, kuzhina, lvanteri, hidrosanitare, instalimi i materialeve prej druri, metalike, plastike dhe xhami, Punime bojatisje, hidroizolim, termoizolim, akustike dhe kundra zjarrit, Kryerja e punimeve ne sherbesa funerale. Projektim te objekteve civile, industriale, turistike te te gjitha llojeve, te furnizimit me uje dhe kolektoreve te shkarkimit, te ujesjelles kanalizimeve urbane e rurale, te rrugeve te te gjitha kategorive, te urave, veprave te ndryshme te artit dhe eskadave, restaurimin e ndertimeve te vjetra e historike etj.Hoteleri, turizem, agjenci turistike, udhetimesh ajrore, tokesore, detare.Agrobiznes. Agjenci imobiliare. Ndertime te ndryshme civile dhe ekonomike, godina banimi,ndertime turistike, duke perfshire dhe ndertime te fshatrave turistike.Ofrimi i sherbimeve te telekomunikacioneve. Tregti me shumice dhe pakice si dhe ofrimi i sherbimeve te pajisjeve te vezhgimit dhe sigurise.Projektim dhe instalim ne fushen e telekomunikacioneve.Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash dhe udhetaresh.Hapje agjenci udhetimesh, shitblerje biletash ne rruge tokesore , detare e ajrore.Tregti bizhuterish e kozmetike.Gatim dhe tregtim i produkteve ushqimore te gatshme dhe gjysme te gatshme. Importim dhe tregtimin me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te artikujve farmaceutike, kozmetike, parafarmaceutike etj. Tregtimin, importimin dhe eksportimin e materialeve te konsumit mjekesor dhe pajisjeve mjekesore. Zhvillimin e aktiviteteve per promocion marketing mjekesor dhe farmaceutik . Import- eksport,tregtimi me pakice e shumice te aparaturave mjekesore,pajisjeve mjekesore dhe pjeseve ndihmese mjekesore e farmaceutike. Import-eksport tregtimi me shumice dhe pakice te materialeve te buta, veshje dhe uniforma spitalore per perdorim te perditshem, te materialeve per perdorim mjekesor dhe tregtim e furnizim i tyre ne subjekte publike e private. Import eksport lende pastrimi, higjenizimi dhe dizinfektimi per perdorim te gjere. Tregeti me shumice dhe pakice import eksport te cdo pjese kembimi per to. Riparim dhe sherbim teknik te te gjithë aparaturave te kujdesit shendetesor. Shitje me shumice dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	me pakice e automjeteve te te gjitha llojeve, pjeseve dhe aksesoreve te tyre, kryerje e riparimeve te te gjitha llojeve te automjeteve, perfshire montimin e automjeteve te perfunduara. Rishitje e kohes se rimbushjes elektronike, kartave rimbushese me gervishtje dhe kartave SIM, si dhe ushtrimin e cdo lloj aktiviteti tjetër te ligjshëm.	
10. Administratori/ët	Suela Meçe	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 03/03/2017	Deri: 09/02/2027
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Dritan Bedo	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Vlore Vlore VLORE Lagjja Pavarsia, Rruga Lidhja e Prizrenit, Kullat 12 kateshe Tirane Kashar KASHAR Autostrada Tirane-Durres, km 11, Godina "Hybrid", kati 0 Vlore Vlore VLORE Lagjja "Pavaresia", Rruga "Kosova", Kullat 12 Kateshe, Z.K 8603, Nr Pasurie 29/127-N10, Dyqani Globe Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga e Durresit, Sheshi "Karl Topia", Njesia 2.1, Kati i trete, Brenda Qendres Tregtare "RING", Dyqani "Globe" Tirane Tirane TIRANE Rruga "Ali Demi", z.k 8180, nr. pasurie 1/904-N23, kati 0. Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Abdi Toptani, Njesi Tregtare Nr.V & VII, Kati -1, brenda Qendres "Toptani Shopping Cener", Dyqani Globe Tirane Kashar MEZEZ Rruga Kasëm Shima, Godine pranë Urës së Mëzezit, magazinë për shitje me shumicë, zona kadastrale 2679, nr pasurie 50/19, kodi postar 1050. Tirane Kashar MEZEZ Mezez, rruga Kasem Shima, godine prane ures se Mezezit, magazine, zona kadastrale 2679, nr	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	<p>pasurie 50/19, kodi postar 1050 Tirane Tirane TIRANE Rruga Papa Gjon Pali i II-te (ish Leke Dukagjini), Ndertesa ABA Business Center, (Qendra Tregtare COIN, Kati +3 Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkiake nr 7, rruga e Kavajes, ndertesa 124, hyrja 3, qendra Globe, pallati Hamzaj, kati i 1-re, kodi portar 1023 Shkoder Shkoder SHKODER Rruga "Qemal Draçini", Nr.pasurie 1/526, ZK 8593 Fier Fier FIER Blv.Kryesor,Lagjia "Apollonia" Rruga "Jakov Xoxa", Pallati Nr,1 1 prane Pjaces, Kod Postar 9301 Vlore Sarande SARANDE Lagjia Nr.1, Rruga "Skenderbeu", zona kadastrale 8641, Nr.Pasurie 14/19 Durres Durres DURRES Deshmoret/12, objekt i ndodhur ne zonen kadastrale 8513, numer pasurie 4/93-N13</p>
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	<p>Emri Tregtar: Globe E-Mail: financa@globeshops.al Telefon: +35544806061 042261450</p>
15. Statusi:	Aktiv

Data: 25/01/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2024/01/25 15:08:40 +01:00
L51715010G2024012515083071
2006





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 042255528

DEGA VENDORE TIRANË

DEKLARATË NOTERIALE

(DEKLARATË ME PËRMBAJTJE TË TJERA)

Nr. repertori: 668

Nr. koleksioni: 225

Tirane më 26/01/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



A2024053950030025821

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 66B Rep.
Nr. 225 Kol.



DEKLARATË NOTERIALE

Sot më datë 26.01.2024 para meje Julian Zhelegu, noter pranë Dhomës së Noterisë TIRANË, u paraqitën personalisht:

Znj. Besa GJEVORI, lindur me 31.10.1981, me Leternjoftim Nr. 037407190 dhe Nr. Personal I16031030N, ne cilesine e **Zv. Drejtor i Departamentit te Biznesit te Madh** prane "BANKA CREDINS" SH.A, Tirane, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tiranë, me vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003, rregjistruar në organin tatimor me Kodin Fiskal Nr.3709529, NUIS Nr. K31608801O, si dhe me Licensën e Bankës së Shqipërisë Nr.16, datë 31.03.2003-----;

Z. Klesti BRACE, lindur me 28.02.1994, me Leternjoftim Nr. 036628502 dhe Nr. Personal J40228031E, ne cilesine e **Analist Kredie**, prane "BANKA CREDINS" SH.A, Tirane, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tiranë, me vendimin Nr. 28969, datë 31.01.2003, rregjistruar në organin tatimor me Kodin Fiskal Nr.3709529, NUIS Nr. K31608801O, si dhe me Licensën e Bankës së Shqipërisë Nr.16, datë 31.03.2003-----;

Të dy personat e mësipërm madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, të cilët deklaruan si më poshtë-----;

"Ne, të sipërnënshkruarit, në cilësinë e përfaqësuesve ligjorë të "BANKA CREDINS" SH.A. me anë te kësaj deklarate, japim pëlqimin qe ne baze te Kontrate Dhurim Kuotash date 28.12.2023, te behet kalimi i pronesise me ane te dhurimit i kuotave qe z. Dritan Bedo zoteron ne shoqerine tregtare "GLOBE SHOPS" sh.p.k. me NUIS L51715010G, ne favor te z. Dardi Çinari, me kusht qe edhe pas ndryshimit te pronesise se tyre, kuotat te vazhdojne të qëndrojnë te bllokuara duke mbartur te gjitha barret siguroese që aktualisht rëndojne mbi to në favor të shoqerisë "Banka Credins"Sh.a.-----"

Kjo deklarate ne asnje rast nuk mund te interpretohet si deklarate lirimi e kuotave te shoqerise tregtare "GLOBE SHOPS" sh.p.k. nga barret siguroese që aktualisht rëndojne mbi to në favor të shoqerisë "Banka Credins"Sh.a.-----

Sa më sipër, deklarojmë nën përgjegjësinë tonë personale-----;

Unë, noteri, pasi dëgjova deklaramet e bëra nga deklaruesit dhe verifikova dokumentet përkatëse, konstatova se deklarata është në përputhje me vullnetin e lirë dhe të pavarur të deklaruesve dhe konform ligjit. Për këtë arsye, unë e nënshkruaj atë duke i dhënë forcën e nevojshme ligjore.-----;

DEKLARUES
"BANKA CREDINS" SH.A.
Besa GJEVORI

Zv. Drejtor i Departamentit te Biznesit te Madh

Klesti BRACE
Analist Kredie



NOTER

Julian Zhelegu
Përfaqësuar me autoritetin
Zevendësues
Edhel Sume

Klesti BRACE